

community

The New Apostolic Church around the world

04/2024/AI

Më i shenjt besim

Kryeartikulli
Jezusi na mëson të lutemi

Shërbesa fetare
Ta ndërtosh jetën që në
themel

Doktrina
Shpirtrat e larguar nga
kjo jetë
Shërbimi i Pjetrit

New Apostolic Church
International



Jezusi na mëson të lutemi



Foto: NAK International

Këtë vit ne po përqendrohemi edhe një herë veçanërisht te lutja. Motoja jonë është: “Lutja vepron!”.

Një herë dishepujt e pyetën Zotin: Si duhet të lutemi që të funksionojë? Ai u shpjegoi atyre se si të luteshin dhe u mësoi atyre Lutjen Ati Ynë. Kjo lutje, e cila vjen nga Zoti Jezus, është ende e rëndësishme për ne. Që të funksionojë, duhet të dimë fjalët. Ne duam ta lutemi ashtu siç na mësoi Jezusi. Por ne gjithashtu duhet ta themi atë në frymën e Jezu Krishtit - domethënë, jo vetëm të themi fjalët që na i mësoi ai, por gjithashtu të lutemi me këto fjalë në frymën e Jezusit.

I lutemi Perëndisë, Atit tonë: U bëftë vullneti yt! Lutja është në të vërtetë e çuditshme sepse ne besojmë dhe e dimë: Zoti është i plotfuqishëm.

Zoti është i plotfuqishëm, ai gjithmonë bën pikërisht atë që dëshiron. Pra, nuk kemi nevojë të lutemi që Zoti i mirë të bëjë atë që dëshiron, pasi ai gjithmonë bën atë që dëshiron, është i plotfuqishëm. Ne nuk lutemi që Perëndia të mund

të bëjë vullnetin e tij, por lutemi që ne të bëjmë vullnetin e Perëndisë.

Çdonjeri duhet të vendosë: A po bëj vullnetin e Zotit apo po bëj vullnetin tim? Ky është kuptimi i lutjes. Ne nuk lutemi: Zot, bëj çfarë të duash! Por ne lutemi: Më ler të bëj, më ler t'i nënshtrohem vullnetit tënd.

Të fala të përzemërta, i juaji



Jean-Luc Schneider

Ndërtojeni jetën që nga themeli



Photos: Jonas Spengler, Bernhard Holdener



Judas 20

Por ju, të dashurit e mi, ndërtoni jetën tuaj mbi besimin tuaj më të shenjtë dhe lutuni në Frymën e Shenjtë.

Të dashur vëllezër dhe motra, Rrëshajët, Pentakosti nuk ishte vetëm derdhja, ardhja e Shpirtit të Shenjtë. Ishte gjithashtu fillimi i punës së apostujve me fuqinë e Frymës së Shenjtë. Pjetri predikoi Ungjillin me këtë fuqi. Ai predikoi se Jezu Krishti ishte Mesia, i dërguar nga Perëndia, i cili vdiq për ne, u ringjall nga të vdekurit dhe u ngjiti në qiell. Jezusi gjithashtu tha se do të vinte përsëri dhe do të shpëtonte ata që besojnë në të, që janë pagëzuar dhe që kanë marrë dhuntitë e Frymës së Shenjtë. Kështu mund ta përmbledhim predikimin e Rrëshajëve, të Pentakostit, pra predikimin e parë të një apostulli nën fuqinë e Frymës së Shenjtë.

Siç dëgjuam në leximin e Biblës (Vep e Apost 2,36-43), tre mijë njerëz besuan në këtë predikim dhe u pagëzuan. Kishat e para qëndruan të patundura në mësimet e apostujve dhe në shpalljen e Ungjillit. Me kalimin e kohës, aty-këtu u ngritën mësues të rremë, të cilët përhapën një doktrinë që nuk korrespondonte më me mësimet e apostujve.

Apostujt dhe njerëzit e tjerë përgjegjës si Juda duhej të thoshin: Mos i dëgjoni, qëndroni në mësimet e apostujve, qëndroni tek Ungjilli! Nuk mjafton që t'i përmbahesh atij, duhet ta ndërtosh jetën tënde mbi besimin, domethënë ta jetosh jetën sipas Ungjillit, sipas mësimave të apostujve. Kjo është po aq e rëndësishme për ne sot. Këta mësues të rremë ekzistojnë edhe sot. Nëpërmjet dhuntive të Frymës së Shenjtë që kemi marrë, ne jemi në gjendje të dallojmë shpirtat dhe të njohim e të refuzojmë herezitë. Fryma e Shenjtë na ndihmon për këtë nëpërmjet predikimit, motrave dhe vëll. tanë të admin. dhe lutjes.

Juda shkruan këtu se nuk mjafton të besojmë në mësimet e apostujve, por duhet ta ndërtojmë jetën tonë mbi to. Në terma konkretë, kjo do të thotë: Ungjilli, mësimi i apostujve, duhet të përcaktojë vendimet tona në jetën e përditshme. Ekziston një rrezik i madh që besimi të ekzistojë vetëm në teori. Ju jeni apostolikë të rinj dhe besoni në Ungjillin dhe mësimet e Apostujve. Por ky besim ndikon vetëm pak në vendimet tona në jetë. Në fakt, ne bëjmë atë që duam. Kjo është e rrezikshme për shpëtimin tonë. Prandaj Fryma e Shenjtë na thotë: Kujdes, nuk mjafton të besosh, por edhe ky besim duhet të prodhojë diçka. Nëse kjo nuk është më kështu, mund të ketë arsye të ndryshme. Do të doja të përmendja dy prej tyre: Mund të zhgënjehesh sepse ajo që besove nuk ndodhi dhe gjithçka doli ndryshe. Ose jeni të shqetësuar sepse gjërat kanë ndryshuar dhe disa prej tyre po predikohen ndryshe se më parë. Dikush pyet veten: Po sikur kjo të mos jetë më e vërtetë? Atëherë pse duhet të jetë e vërtetë edhe pjesa tjetër? Ky është një fenomen që e vërej. Disa vëllezër e motra janë të shqetësuar kur kuptojnë se diçka u mësohej ndryshe në të kaluarën, dhe tani interpretohet krejt ndryshe.

Juda përmbledh mesazhin për sot: Ndërtoni jetën tuaj në besimin tuaj më të shenjtë. Ne duhet të përqendrohemi në besimin e shenjtë. Besimi i shenjtë është ai që vjen drejtpërdrejt nga Zoti, Ati, Fryma e Shenjtë dhe Jezu Krishti. Pse e them këtë? Sepse besimet tona personale janë komplekse. Ai bazohet, para së gjithash, në Bibël, në Ungjill dhe në mësimet e apostujve në kuptimin biblik. Jo predikimi i sotëm, por se si apostujt e asaj kohe predikonin dhe shkruanin Ungjillin. Kjo është baza e besimit tonë.

Por ka edhe gjëra të tjera: Para së gjithash, edukimi ynë. Shumë prej nesh u rritën si Apostolikë, prindërit tanë, paraardhësit tanë, motrat e vëll e admin., na dhanë këshilla dhe udhëzime se si të sillemi me sakrificën për t'u bekuar, si të sillemi me lutjen për të qenë të bekuar, si duhet të sillemi

në përgjithësi. Kjo është një seri e tërë që të gjithë e mësuam përmes edukimit tonë.

Pastaj u rritëm dhe u zhvilluam, fituam përvojat tona dhe kuptuam se: Nëse i trajtojmë gjërat në këtë mënyrë dhe nëse ndjekim këtë rrugë, atëherë Zoti i mirë përgjigjet dhe ndihmon. Kjo është diçka shumë e bukur, një pasuri më vete.

Për më tepër, besimi ynë bazohet në predikimet e shumta që kemi dëgjuar gjatë dekadave. Kjo përfshin edhe interpretimin e fjalëve dhe imazheve të Biblës që janë të njohura për ne, që thjesht na përkasin neve, të gjitha historitë që dëgjuam. E gjithë kjo është bërë pjesë e besimit tonë dhe kjo është gjithashtu një gjë shumë e bukur. Është pjesë e besimit tonë.

Më në fund, janë edhe ato këshilla që na thuheshin: Mos u shqetëso, do të shërohesh, Zoti i mirë do të ndihmojë.

Mund të tregojmë shumë se sa shpesh

na janë bërë këto premtime. Kemi përjetuar që apostulli apo prifti na ka thënë diçka dhe kjo është realizuar. Ne u lutëm dhe besuam dhe Zoti i mirë na ndihmoi. Ky është i gjithë filli i besimit tonë.

Por ky nuk duhet të barazohet me besimin më të shenjtë; sepse në të gjitha këto që dëgjuam ekziston ajo që vjen drejtpërdrejt nga Perëndia, e përzier me atë që vjen nga njerëzit. Nuk dua ta heq fare këtë të fundit, pasi është shumë e vlefshme, por duhet të kuptosh që nuk vlen kudo dhe jo për të gjithë. Vëmë re se vetë e bëmë këtë pesë herë dhe funksionoi. Por jo herën e gjashtë. Pse jo? Na u premtua diçka, e besuam, u lutëm, bëmë gjithçka që na thanë dhe ajo që u premtua nuk u realizua. Në disa vende gjërat bëhen në këtë mënyrë, në të tjera në atë mënyrë. Por fjala e Zotit vlen gjithmonë dhe kudo. Juda këtu na këshillon të përqendrohemi në besimin më të shenjtë; për atë që vërtet vjen nga Perëndia dhe ajo që është e vlefshme për ju dhe për të gjithë njerëzit e Perëndisë gjithmonë dhe kudo: Ungjilli, mësimi i Jezu Krishtit, i cili predikohet nga apostujt.

Këta elementë themelorë të besimit tonë përmbledhen në dhjetë artikujt e besimit apostolik të ri. Kjo është ajo që përbën besimin tonë të shenjtë. Ne besojmë në Zotin, Krijuesin e plotfuqishëm. Asgjë nuk është e pamundur për të, ai bën pikërisht atë që dëshiron. Ne besojmë në Jezu Krishtin. Ne besojmë në misionin e tij, në vdekjen e tij, në ringjalljen e tij, në ngjitjen e tij në qiell, në ardhjen e tij të dytë dhe në mësimet e tij. Ai na zbuloi Zotin ashtu siç është: Zoti është dashuri, ai dëshiron shpëtimin e njerëzve.

Ndërtojeni jetën tuaj mbi më të shenjtin besim



*Zoti është vetë
dashuria, ai dëshëron
shpëtimin e të gjithë
njerëzve*

Ne besojmë në këtë! Ne besojmë në Frymën e Shenjtë, nëpërmjet së cilës Zoti është i pranishëm në tokë sot. Ju nuk mund ta shihni atë, por ne mund ta perceptojmë punën e tij.

Ne besojmë në jetën e përjetshme. Shpëtimi që do të na japë Zoti është bashkimi i përjetshëm i njerëzve me Zotin. Ne, si fryti i parë, mund ta marrim atë dhe të hyjmë në mbretërinë e Perëndisë në ditën e kthimit të Krishtit. Për njerëzit e tjerë ekziston mundësia e arritjes së shpëtimit dhe jetës së përjetshme në mbretërinë e paqes. Atëherë të gjithë njerëzit që janë të shpëtuar do të jetojnë në shoqëri të përjetshme me Perëndinë në Krijimin e ri. Dhe ne besojmë se kemi nevojë për Kishën e Krishtit për të arritur këtë shpëtim. Kjo



është thelbësore. Ne kemi nevojë për sakramentet, kemi nevojë për apostujt e dërguar nga Jezu Krishti dhe ne kemi nevojë për postet e zgjedhura nga Perëndia dhe të dhëna nga apostujt me një pjesë të autoritetit të tyre.

Ky është besimi ynë më i shenjtë. Asgjë nuk ka ndryshuar në të në vitet e fundit. Ai vlen në të gjithë botën, në Afrikë,



në Amerikë, kudo. Le ta ndërtojmë jetën tonë mbi këtë themel. Le të vendosim besimin në këto elemente, të cilat tani i kam reduktuar në pesë, le t'i marrim vendimet tona në jetën e përditshme mbi këtë besim.

Çfarë do të thotë kjo? Para së gjithash, fjala e Jezu Krishtit ka gjithmonë më shumë peshë për mua sesa ajo që më thonë njerëzit. Unë besoj në plotfuqinë dhe dashurinë e Zotit, çfarëdo që të vijë. Kjo konkretizohet shumë shpejt kur bëhet fjalë për marrjen e vendimeve në jetën e përditshme.

Besimi në jetën e përditshme do të thotë se shoqëria e përditshme me Perëndinë në mbretërinë e tij është gjëja më e rëndësishme për mua. Ajo është gjithmonë një prioritet. Por edhe sot dua të jem me dhe pranë Jezusit, të kem shoqëri me të. Kjo përcakton vendimet e mia të jetës.

Si pasojë, nëse besoj në mësimet e Jezusit, është shumë e rëndësishme për mua të ndjek urdhëresën për të dashur Perëndinë mbi gjithshka dhe të afërmin si veten time. E kam thënë këtë shumë herë më parë, por është kaq e rëndësishme: Të duash Perëndinë do të thotë që gjithçka që bëj për Zotin bëhet nga dashuria për të dhe jo nga llogaritja.

Po kthehem te këshilla e mirë që na është dhënë. Kjo është e gjitha plotësisht në rregull. Unë vetëm ndonjëherë kam një problem të vogël me faktin se herë pas here ka pak përllogaritje pas saj: Nëse e bëni këtë, atëherë Zoti do t'ju japë këtë apo atë, por kjo nuk është dashuri. Ne duhet të rritemi në dashuri dhe në dashuri siç deshi Jezu Krishti, pa llogaritje. Kur bëjmë diçka për Zotin e mirë, zbatojmë urdhëresat e tij, i shërbejmë atij, kjo bëhet vetëm për një arsye: sepse ai na do. Sepse ai na jep kaq shumë, tashmë na ka dhënë aq shumë dhe do të na japë shumë më tepër. Kjo dashuri duhet të përcaktojë vendimet tona. Këtu ka ende vend për përmirësim.

Sigurisht që e dua fqinjin tim! Dashuria për fqinjët tanë duhet gjithashtu të përcaktojë në mënyrë specifike vendimet tona në jetën e përditshme. Ndonjëherë kjo dashuri është paksa shumë teorike. Shumë fjalë, por për fat të keq vetëm pak veprime. Ekziston një histori e bukur për këtë në Afrikë:

Një fetar pyet një burrë: "A e do të afërmin tënd?" Sigurisht i pergjigjet ai "Pra, nëse do të kishit dy shtëpi, a do t'i jepnit një shtëpi një personi të varfër?" "Po, sigurisht, unë e dua,



Apostuli i distriktit Edy Isnugroho

Apostujt e distrikteve nga e majta në të djathtë: Rainer Storck, Kububa Soko, Michael Deppner, Peter Schulte dhe Michael Ehrich



Apostuli i distriktit Enrique Minio

komshiun tim!". "Po të kishit dy makina, a do t'ja jepnit një komshiut tënd", pyet kleriku. Burri i përgjigjet: "Po, sigurisht, unë e dua, komshiun tim!" "Po të kishë dy pallto a do t'ja jepje një komshiut tënd?" "Jo" iu pergjigj ai. "E përse jo?", pyeti kleriku "Sepse vetëm dy pallto kam!"

Një histori e vogël nga Afrika, por kaq domethënëse. Nuk dua të them asgjë më shumë për të. Unë ju kërkoj - dhe këtu përfshij edhe veten time - thjesht ta merrni këtë me vete. Jo vetëm fjalë, por edhe veprime shumë konkrete. Një pjesë e besimit më të shenjtë është: Ne besojmë se Jezusi pret që ne ta duam Perëndinë mbi të gjitha dhe të afërmin si veten tonë. Atëherë kjo duhet të bëhet konkrete herë pas here.

Një pikë e fundit: Ne besojmë se për të arritur shpëtimin, Kisha, posti i apostujve, sakramentet, shërbesat janë thelbësore. Vëllezër dhe motra, ne duam të vendosim një herë e përgjithmonë se kisha është atje kryesisht për shpëtimin tonë. Sigurisht që ka çështje materiale si ndërtimi, organizimi, aktivitetet e ndryshme. Kjo është e gjitha e mirë dhe e rëndësishme. Por nëse i përkasim kësaj kisha, shkojmë në shërbesat fetare dhe jemi pjesë e bashkësisë, kjo është kryesisht sepse është e nevojshme për shpëtimin tonë. Çdo gjë tjetër është padyshim dytësore. Zemërimi për gjëra të parëndësishme nuk duhet të më

bëjë që të mos shkoj në kishë. Kisha nuk është thjesht një organizatë, një klub i bukur. Më është dhënë nga Zoti që të arrij shpëtimin. Ky është besimi ynë dhe ne duam t'i përmbahemi atij. Ky besim duhet të përcaktojë vendimet tona. Le ta përqendrojmë besimin tonë në pjesën më të shenjtë të tij. Çdo gjë tjetër është e bukur, e rëndësishme dhe e vlefshme. Por nuk mund të barazohet me besimin më të shenjtë. Ne duam të fokusohemi në këtë.

Apostuli kryesor Jan-Luc Schneider në shërbesën fetare të Pentakostit në Luzern (Zvicër)



Zoti i mirë na ndihmon për këtë dhe na ka dhënë një mjet të bukur: lutjen. Ai thotë: ...dhe lutuni nën Frymën e Shenjtë. Përse? Sepse janë të lidhura së bashku. Për të bërë njërën, ne duhet të bëjmë edhe tjetrën. Zoti i mirë - kur i lutemi atij në Frymën e Shenjtë - na ndihmon të përqendrohemi dhe të ndërtojmë besimin më të shenjtë. Është Zoti i plotfuqishëm, Perëndia i dashurisë, ai që dëshiron mbi të gjitha shpëtimin tonë. Kur i lutemi, Fryma e Shenjtë na thotë: Mos harroni çfarë ka bërë Zoti për ju, çfarë po bën për ju, çfarë do të bëjë për ju. Është bërë shumë tashmë. Fryma e Shenjtë na thotë të përqendrohemi në jetën e përjetshme. Kur lutemi në Frymën e Shenjtë, lutja jonë përfshin mbi të gjitha: I dashur Zot, forco besimin tim, ndihmo mosbesimin tim, forco dashurinë time për ty, forco dashurinë time për të afërmin tim.

Ne lutemi për fqinj tonë, veçanërisht për shpëtimin e tij: I dashur Zot, më ndihmo të jem një mjet në dorën tënde që të mund të kontribuoj në shpëtimin e njerëzve. Ne nuk i tregojmë Zotit se çfarë duhet të bëjë me fqinj tonë, por i kërkojmë që ta ndihmojë të arrijë shpëtimin. Kërkesa e fundit që ne i bëjmë Zotit të frymëzuar nga Fryma e Shenjtë është: Zot eja sa më shpejt!

Ky është mesazhi i sotëm. Ne duam të përqendrohemi në elementet bazë të besimit tonë. Ato duhet të përcaktojnë

jetën dhe vendimet tona. Ne gjejmë ndihmë nga Perëndia duke u lutur në Frymën e Shenjtë. A mund të shpreh një dëshirë? Do të ishte mirë që drejtuesit e shërbesave fetare t'i merrnin përsëri këto ide dhe t'i përpunonin më tej në shërbesat e ardhshme fetare, edhe nëse nuk janë të shkruara në Mendimet Udhëzuese. Është shumë e rëndësishme për mua që ky mesazh të transmetohet vërtet.

Mendime kyce

- Apostujt predikojnë Ungjillin me fuqinë e Frymës së Shenjtë.
- Ne i besojmë mësimet e tyre dhe e jetojmë jetën tonë në përputhje me to.
- Të udhëhequr nga Fryma e Shenjtë, ne lavdërojmë Zotin, kërkojmë hirin e Tij, ndërmjetësojmë në lutje për Kishën dhe lutemi për kthimin e Zotit.

I Apostulli Franz-Wilhelm Otten në Shqipëri



Apostuli ynë Otten midis motrave të reja të emëruara në postin e diakoneve

I organizoi në kujtim të kontributit dhe shërbimit që prifti e vëllai ynë Elton Demollari ka bërë ndër vite për Kishën Apostolike të Re në Shqipëri e Kosovë.

Ne 19 Prill 2024 Apostulli Otten erdhi perseri në Tiranë. Këto vizite të dytë në Shqipëri Apostulli Otten e kishte shpallur në planin e shërbimeve vjetore. I planifikuar që në fillim që edhe seminari ditën e shtunë me 20 Prill me vellezerit e administratës të kishës sone. Në këtë seminar Apostulli trajtoi temën mbi “uniteti dhe

diversiteti” I Kishës Apostolike të Re. Ditën e diele, më 21 Prill 2024 ora 10.00 Apostulli mbajti shërbesën Fetare në Kishën Apostolike të Re Tiranë me fjalën e marrë nga Efesianet 1,21-22 si predikues i dytë, shërbeu Ev. Fatmir Elezi. Gjate kesaj shërbese Apostulli Otten emëroi për here të parë në Shqipëri me detyrën e diakoneve 4 motra nga bashkësitë Tiranë dhe Elbasan. E pikërisht për bashkësinë e Tiranës motrat Elda Rako, Fiona Rako, Tea Ndrijo si dhe për bashkësinë e Elbasanit motrën Ajkuna Gugu. Në këtë shërbese morën pjesë 29 motra e vellezer.

Po ditën e diele më 21 Prill 2024 ora 17.00 apostulli Otten mbajti shërbesën në kishën e Lushnjës. Apostulli shërbeu me fjalën e marrë nga Mateu 25,21. Si predikues i dytë, shërbeu kryeplaku Andrea Rafaeli. Edhe në këtë shërbese apostulli Otten ngarkoi me detyrën e diakoneve 3 motra nga bashkësitë e Lushnjës e Kucovës, Bashkësia Lushnje gëzoi për emërimin e motrës Sara Cela, bashkësia Kucove gëzoi për dy diakone, motrat Elsa Rafaeli dhe Rezarta Dokaj. Në këtë shërbese morën pjesë 49 motra e vellezer nga bashkësitë Lushnje, Fier, Kucove e Dimal. I urojme motrave të emëruara në detyrën e diakoneve në Kishën Apostolike të Re një shërbim të mbare në misionin e tyre për të shërbyer motrave e vellezerve nëpër bashkësitë ku u caktuan. Falenderojme Apostullin tone kujdestar Otten për këtë emërim, gjë që do t’i japë Kishës sone një frymëmarrje të re dhe mbështetje për administratën e kishës sone si dhe besimtarëve nëpër bashkësitë e tyre.

Apostul Otten erdhi 4 here në Shqipëri gjatë muajit Prill 2024. Në 7 Prill ora 10.00 në Kishën Apostolike të Re në Tiranë, mbajti shërbesën fetare për vellezerit e motrat e bashkësive Tiranë dhe Elbasan. Mbas shërbesës së radhës Apostulli bëri një shërbim të vecantë në kujtim të shërbimit e kontributit të vëllait tone Priftit Elton Demollari, i cili ndërroi jetë në ditën e Pashkëve. Fjala që Apostulli mori për këtë shërbese fetare ishte nga Luka 24,10-11.

SI shërbim i dytë në këtë ceremoni mortore, shërbeu edhe kryeplaku Andrea Rafaeli. Këto shërbese e ndoqën 66 pjesëmarrës nga bashkësitë e Tiranës e Elbasanit ku i ndjeri vëllai kishte shërbyer 12 vjet. Në këtë ceremoni mortore, përveç motrave dhe vëllezërve të kishës, morën pjesë edhe prinderit e Eltonit babai Bashkim, nena Ervehe si dhe bashkeshortja Elda dhe 2 femijet Juara e Sion të shoqëruar nga të afërm të familjes Demollari.

Po në 7 Prill 2024 ora 17.00 Apostulli Otten mbajti shërbesën e dytë në Kishën Apostolike të Re në qytetin e Fierit, me pjesëmarrjen e bashkësive Lushnje e Kuçovë. Edhe kjo shërbese ishte motivuar në kujtim të kontributit që vëllai ynë, prifti Elton Demollari ka dhënë në bashkësitë e distriktit të Jugut. Kisha e Fierit ishte mbushur plot me 55 vellezer e motra të adhur nga bashkësitë e Lushnje, Kucovës e Dimal. Në këtë shërbesë Apostulli Otten mbajti fjalën e marrë nga 1 Selanikasit 5,10. Si predikues i dytë, shërbeu BE. Alfred Rako. Këto dy shërbesa Apostulli Otten

I Sherbesa e Apostullit Otten ne Shqiperi



Me date 21 prill 2024 , Apostulli Otten mban dy sherbesa ne Shqiperi. Si gjithmonë me gezim dhe shume entuziazem pritem takimin me Apostullin , por kete here sherbesa mbarte me shume emocione dhe surpriza. Alatri i zbukuruar dhe i mbuluar nga lulet , buzeqeshja ne fytyrat e pjesëtareve të mbushnin plot me energjine e tyre positive.

Kete here dicka novative mberriti edhe ne vendin tone. Apostulli emeroi shtate nga motrat tona si Diakone. Pra Kisha Apostolike e Re sapo mori 7 diakonet me te reja ne sherbimin e saj. Motrat pranuan me kenaqesinë e tyre me te madhe te mbanin kete titull dhe te zhvillojne punen e tyre tashme plot vullnen dhe deshire.

Në 1 Korintasve 14,33b-36 është një pasazh ku sipas tij grate ne kisha duhet te qendrojne te heshtura , por ky pasazh hidhet poshte nga 1 Kor 11,5. Ky diskriminim ndaj gruas mbeshtetet tek Eva e cila simbolizohet si mekatarja e parë. Por kjo deklarate nuk mund te justifikohet per te perjashtuar grate nga sherbimet qe ato mund te ofrojnë ne kisha.

Burrë apo grua, te gjithë jemi femije te Perendisë dhe kemi detyrat tona per t'i sherbyer Zotit me vullnet dhe deshire. Te gjithë jemi krijuar sipas "shembeltyres se Zotit" dhe jemi i te njejtës natyre dhe dinjitet, te dyja gjinitë jane krijuar te jetojne sebashku pra kemi te drejta te barabarta si ne jeten e perditëshme ashtu edhe ne sherbimin qe mund te ofrohet ne kisha.

Apostulli Otten e shpejgoi kete me se miri ne sherbesat qe ai mbajti ne bashkesine e Tiranës , ku ishte e pranishme



Apostulli Otten gjatë emërimit te diakoneve të reja

edhe bashkesia e Elbasanit dhe ne sherbesen e bere ne bashkesinë e Lushnjes ku mori pjese bashkesia e Fierit , Kucoves dhe e Uravajgurore.

Ne oren 10:00 apostulli sherbeu ne bashkesine e Tiranës, ku dhe emeroi kater nga motrat tona dhe ne oren 17:00 sherbeu ne bashkesine e Lushnjes ku emeroi tre nga motrat tona. Lumturinë e motrave qe u emeruan diakone, e ndjenim te gjithë ne zemrat tona. Pas sherbeses u mblodhem te gjithe sebashku per te kaluar kohe me apostullin tone, duke shkëmbyer historira dhe ndodhi nga ato që kemi perjetuar si ne por gjithashtu edhe apostulli. Me gjithë zemer i uruam apostullit nje udhetim te sigurt dhe komfort per ne shtepine e tij dhe u larguam per ne shtepite tona me shpirt te paster dhe te ushqyer me fjalën e Zotit.

Presim serisht me mall sherbesen e rradhes qe do te mbajë apostulli ne Shqiperi dhe I urojme nga zemra motrat tona diakone per postin qe ato moren dhe dëshërojmë që ato ta kryejnë ate sa më mire duke shpërndarë fjalën e Perendise.

Emërime të reja në bashkësitë e Shqipërisë



Pas një ngjarjeje të dhimbshme siç qe ajo e ndarjes nga jeta e priftit tonë, vëllait, Elton Demollari, disa nga bashkësitë në Shqipëri përjetuan shërbesa të bukura në të cilat Apostulli Otten emëroi në detyrë disa motra diakone. Ky ishte një event i veçantë pasi motrat e emëruara ishin të parat motra të administratës për Shqipërinë.

Në shërbesat e datës 21 Prill, apostulli Otten emëroi motrat Elda Rako, Fiona Rako dhe Tea Ndrio për bashkësinë e Tiranës; motrën Ajkuna Gugu për bashkësinë e Elbasanit; motrën Sara Çela për bashkësinë e Lushnjes dhe motrat Elsa Rafaeli dhe Rezarta Dokaj për bashkësinë e Kuçovës, të gjitha si diakone. Ajo e dielë ishte një ditë shumë e gëzueshme për të gjithë besimtarët, dhe veçanërisht për ne motrat.

Ndjesia e marrjes së detyrës për mua ishte si asnjë tjetër. Vështirë ta përshkruaj me fjalë, por mund të them se ishte diçka shumë e bukur dhe e madhe. Dora e apostullit mbi kokën time, fjalët që ai thoshte, më pas dhe bashkësia që gëzonte ... të gjitha ishin ndjesi drithëruese për zemrën time. Ishte si një festë e brendshme. Të gjitha urimet që u shkëmbyen në fund të shërbesës, si dhe fjalët inkurajuese të vëllezërve të administratës dhe apostullit, vetëm i shtonin lumturisë që ndjeja.

Tashmë që ka kaluar pak kohë nga marrja e detyrës ne e kuptojmë më mirë se çfarë duhet të bëjmë. Të marrësh një

detyrë në kishë, shtëpinë e Zotit, është një bekim i madh, por duhet të mos harrojmë që kjo detyrë vjen dhe me një përgjegjësi të shtuar. Të jesh një diakon/diakone do të thotë të qëndrosh sa më afër motrave dhe vëllezërve, jo vetëm duke i pritur me gëzim ata tek dera, por duke i qëndruar afër në problemet dhe vështirësitë që mund të kenë. Ne bëhemi personat tek të cilët ata mund të drejtohen kur kanë nevojë për dikë që tua dëgjojë problemin, dhe ne duhet të jemi aty për ti dëgjuar dhe me diturinë që Zoti na jep, ti tregojmë rrugën e duhur. Si diakonë, ne bëhemi dhe krahu i djathtë i priftërinjve, duke mos i lënë ata vetëm në detyrën e tyre dhe duke qënë gjithmonë gati për të ndihmuar nëse lind një problem. Ne duhet të shpërndajmë fjalën e Perëndisë, në altar por edhe me njerëz të tjerë gjatë jetës sonë të përditshme. Secila prej këtyre dhe më shumë, janë të rëndësishme për detyrën tonë si diakone.

Ajo për çfarë i lutemi Zotit çdo ditë është të na japë përgjigjet e sakta në momentet e duhura, e të na udhëheqi në rrugën tonë si diakone të reja.



Apostulli Otten emëron diakone në Lushnje e Kuçovë

DAVIDI MUZIKON PËR SAULIN

SIPAS 1 SAMUELIT 16-20T

Mbreti Saul kish mëkatuar. Ai e kupton se Zoti nuk është më në anën e tij. Zoti tashmë ka zgjedhur një mbret të ri. Sauli është i frikësuar dhe në humor të keq. Shërbëtorët e tij shkojnë të kërkojnë dikë që mund t'i binte harpës për të gëzuar mbretin. Dikush u tregon atyre për Davidin dhe Davidi vjen në oborrin e mbretit.

„Sauli goditi një mijë, por Davidi goditi dhjetë mijë“.
Davidi është heroi i ri dhe njerëzit e pëlqejnë më shumë se mbretin. Për më tepër, Perëndia zgjodhi Davidin si pasues të Saulit. Sauli bëhet gjithnjë e më me inat dhe një ditë, i zemëruar, i gjuan me një shtizë Davidit. Davidi është në gjendje të shmangë shtizën dy herë. Por Sauli dëshiron të vrasë Davidin.

Sa herë që mbreti Saul është në humor të keq, Davidi i bie harpës dhe e gëzon atë. Mbreti e do Davidin.

Pastaj Davidi mundi gjigantin Goliat. Mbreti Saul bëhet xheloz dhe ziliqar ndaj Davidit, sepse ai është një luftëtar i mirë dhe izraelitët thonë:



Jonathani, i biri i Saulit, ngrihet në mbrojtje të Davidit para babait të tij: “Ai gjithmonë ka luftuar për ty, ka mundur gjigantin Goliat, nuk të ka bërë asgjë të keqe. Pse dëshiron të vrasësh një njeri të pafajshëm?» Sauli i premtun djalit të tij se nuk do t’i bëjë keq Davidit.

Edhe një herë Davidi kthehet nga beteja fitimtar. Pastaj ndodhi kjo: Mbreti e harron premtimin e tij dhe i gjuan përsëri me një shtizë Davidit, ndërsa ai po luante muzikë. Davidi thjesht mundi ta shmangë atë përpara se shtiza të mbeste e ngulur tashmë në mur. Po atë natë, Davidi ikën.

PËR VIZITË TE MAKAFUI NË ACCRA (GANË)

Mirë se vini në Afrikën Perëndimore. Këtu në Ganë, shumë fëmijë që kanë lindur janë emëruar sipas ditëve të javës. Afua, për shembull, është emri i një vajze që ka lindur të premten. Emri im është Makafui. Emri nuk vjen nga dita e lindjes sime, por do të thotë: "Dua të lavdëroj Zotin".



Një nga mënyrat se si unë lavdëroj Zotin është përmes muzikës. Unë luaj në violinë dhe marr pjesë në orkestrën e kishës.

Në Ganë, rreth shtatë nga dhjetë banorë janë të krishterë. Ne kemi dalë në fotografi përpara ndërtesës së kishës sonë me disa nga motrat dhe vëllezërit apostolikë të rinj nga bashkësia ime.



Në vendin tonë, të gjithë fëmijët duhet të shkojnë në shkollë për nëntë vjet. Nëse dëshirojmë të vazhdojmë të mësojmë më pas, duhet të paguajmë tarifat e shkollës. Por një në tre fëmijë në Ganë nuk mund të shkojë në shkollë: ka shumë pak shkolla në fshatrat në veri, shumë fëmijë jetojnë në rrugë në qytetet e mëdha dhe të tjerët duhet të mbajnë familjet e tyre dhe të shkojnë në punë. Unë ndjek një shkollë të krishterë dhe shkollën e së dielës.



Futboli luan një rol të madh për ne. Unë gjithashtu luaj futboll, për fat mund të luaj gjithmonë me një nga vëllezërit e mi. Kur nuk jam jashtë, luaj në Playstation.



Familja ime përbëhet nga nëna ime Gifty, babai im David, vëllezërit e mi Selase (15) dhe Eyram (13) dhe unë. Unë jam njëmbëdhjetë vjeç. Prindërit e mi punojnë si nënpunës administrate dhe si drejtor menaxhues.



Ne jetojmë në Accra, i cili është qyteti më i madh dhe gjithashtu kryeqyteti i vendit tonë. Accra ndodhet direkt në det.

Ganezët hanë kryesisht ushqime të nxehta; edhe për mëngjes. Ushqimi im i preferuar është bërçolla e derrit me petull të skuqur. Ne e hamë këtë herë pas here në shtëpi.



Gana e fitoi pavarësinë në vitin 1957. Presidenti i parë ishte Kwame Nkrumah. Për nder të tij u krijua një park në qendër të qytetit Accra. Aty është varrosur ai dhe në kujtim të tij është ngritur edhe ky monument. Dita e Pavarësisë festohet në mënyrë madhështore. Së shpejti do të festohet përvjetori i saj: 6 Mars.





Mendime rreth shpirtrave te larguar nga kjo jete

Cila është gjendja e njerëzve në jetën e përtejme? Çfarë shpëtimi u ofrohet atyre që tashmë nuk rrojnë, kur dhe si? – Kjo letër, ky shkrim i apostullit kryesor jep përgjigje nga besimi apostolik i ri.

Që nga Dita e Rrëshajëve, Fryma e Shenjtë ka punuar në Kishën e Krishtit për të dëshmuar dhe lavdëruar Jezu Krishtin (Gjoni 16,14). Falë fuqisë së saj, apostujt e parë mundën të përmbushnin misionin që Jezusi u kishte besuar atyre. Jezusi u premtoi atyre se Fryma e Shenjtë do t'i ndihmonte dhe do t'u kujtonte fjalët e tij në kohën e duhur (Mat. 10,20; Gjoni 14,26). Kjo ndodhi kur Pjetri duhej të dilte para Këshillit të lartë. Fryma e Shenjtë i kujtoi atij se Jezusi kishte thënë: “Unë jam udha, e vërteta dhe jeta; Askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje” dhe kjo i dha atij guximin t'u shpallte njerëzve se besimi në Jezu Krishtin është e vetmja mënyrë për të arritur shpëtimin.

Fryma e Shenjtë vepron nëpërmjet apostujve të sotëm po në të njëjtën mënyrë. Në përputhje me detyrën që morën nga Dërguesi i tyre, ata u shpallin të gjithë njerëzve se Perëndia

dëshiron shpëtimin e tyre dhe se e vetmja mënyrë për ta fituar atë është të besojnë dhe të ndjekin Jezu Krishtin. Pasi Jezusi arrin fitoren mbi vdekjen, mesazhi i shpëtimit u drejtohet të gjallëve dhe të vdekurve (1 Pjetrit 4,6).

Njeriu në botën e përtejme

Në kohën e vdekjes, shpirti dhe fryma largohen nga trupi i njeriut për të hyrë në botën e përtejme. Trupi humbet, por personaliteti i të ndjerit mbetet. Ne besojmë, dhe kjo është një nga veçoritë e veçanta të besimit apostolik të ri, se ata që tashmë nuk rrojnë ruajnë lirinë e tyre të zgjedhjes: ata mund të vendosin lirisht për ose kundër Jezu Krishtit.

Situata e njeriut në jetën e përtejme varet, nga njëra anë, nga afërsia ose largësia e tij me Jezu Krishtin dhe, nga ana tjetër,



nga shkalla e fajit që ai ka marrë mbi vete, të cilën vetëm Zoti mund ta masë. Për të shprehur këto situata të ndryshme, Bibla përdor imazhe, tablo të ndryshme. 1 Pjetrit 3,19 flet për shpirtrat e pabindur «në burg». Jezusi tha se ekzistojnë "banesa" të ndryshme në shtëpinë e Atit (Gjoni 14:2). Ne ndonjëherë flasim për "zona, vende të ndryshme në jetën e përtejme". Termi "burg", i cili përdoret shpesh në këtë kontekst, nuk duhet të merret fjalë për fjalë. Imazhi thjesht i referohet faktit se ata që tashmë nuk rrojnë mbeten robër të mëkatit dhe për këtë arsye nuk janë në gjendje t'i afrohen Perëndisë. Po kështu, termat "banesa" ose "zona" nuk do të thotë se Zoti i mbledh ose i burgos të gjithë të vdekurit e të njëjtit "profil" në të njëjtin "vend": gënjeshhtarët midis gënjeshhtarëve, vrasësit midis vrasësve, etj... Zoti nuk bën nuk i rendit njerëzit në kategori, Ai e shikon secilin prej jush si një person unik! Gjithçka që mund të themi është se gjendja e atyre që tashmë nuk rrojnë varet nga marrëdhënia e tyre me Jezu Krishtin dhe nga niveli i fajit të.

Oferta per shpetim sot

Këtu dhe në botën tjetër, shpëtimi në Krishtin është mëshirë, është një hir që Zoti ia jep kujt të dojë dhe kur të dojë. Ai u jep atyre që ai ka zgjedhur për shpëtim mundësinë për të njohur Ungjillin. Për t'u shpëtuar, të larguarit nga kjo jetë që e kanë marrë këtë hir duhet të zgjedhin të pranojnë Ungjillin, të besojnë në Jezu Krishtin, të marrin sakramentet e administruara nga apostujt dhe të ndjekin Ungjillin.

Le të kujtojmë se sasia e kohës që ka kaluar një person që tashmë nuk rron në një "zonë" nuk ka asnjë ndikim në shpëtimin e tyre. Vetëm për shkak se ai ka "vuajtur" mjaft gjatë në një "burg" nuk do të thotë se ai do të shpëtohet automatikisht. Ka vetëm një mënyrë për të ardhur te Perëndia, dhe ajo është nëpërmjet besimit në Jezu Krishtin!

Gjatë marrjes së sakramenteve, Krishti "liron" ata që tashmë nuk rrojnë në të njëjtën mënyrë që çliron ata që janë të gjallë: ata që pagëzohen me ujë çlirohen nga mëkati fillestar dhe mund t'i afrohen Perëndisë. Ata që janë pagëzuar me Frymën e Shenjtë marrin premtimin e jetës së përjetshme dhe mundësinë për të hyrë në Mbretërinë e Perëndisë si frytet e para. Marrja e denjë e Darkës së Shenjtë u mundëson atyre të jenë në bashkësi me Krishtin dhe të zhvillohen sipas shëmbëlltyrës së tij.

Kur ai të kthehet, Zoti do të marrë nga kjo botë dhe ajo botë të zgjedhurit që janë përgatitur nga Fryma e Shenjtë. Fryma dhe shpirti i tyre do të marrin një trup të ri, trupin e ringjalljes, me të cilin do të hyjnë në lavdinë e Perëndisë.

Oferta e shpëtimit në mbretërinë e paqes

Për shkak se Zoti dëshiron shpëtimin e të gjithë njerëzve dhe ky shpëtim mund të arrihet vetëm nëpërmjet Krishtit, ai do t'i mundësojë çdo personi të zgjedhë lirisht Krishtin. Gjatë mbretërisë së paqes, shpëtimi do t'u shpallet të gjithë njerëzve, të vdekur dhe të gjallë. Të gjithë do të kenë mundësinë të ndjekin Krishtin. Në fund të kësaj kohe, i ligu do të ketë mundësinë të joshë njerëzit. Pra, të gjithë, me njohuri të plota rreth çështjes, mund dhe duhet të vendosin pro ose kundër Krishtit.

Në Gjygin e Fundit, ata që kanë ndjekur Krishtin do të hyjnë në Krijimin e ri. Të tjerët do të ndahen përfundimisht nga Zoti.

Le të kujtojmë gjithashtu:

- Nëse fati i njeriut do të finalizohet në kohën e vdekjes së tij, një pjesë e madhe e njerëzimit nuk do të kishte akses për shpëtimin në Krishtin.
- Një mësim që thotë se Perëndia, në mirësinë e tij të madhe, mund të shpëtojë njerëzit pa qenë nevoja që ata të besojnë në Krishtin, është i papajtueshëm me detyrën që Jezusi u dha apostujve të tij. Apostujt nuk mund të predikojnë asnjë doktrinë që do të ishte në kundërshtim me atë të Jezusit.
- Doktrina e Mbretërisë së Paqes Mijëvjeçare bazohet në bindjen se Perëndia dëshiron t'u japë të gjithë njerëzve mundësinë për t'u shpëtuar nëpërmjet besimit në Jezu Krishtin.

Si e mbron Perendia kishën

Pas ardhjes, derdhjes së Frymës së Shenjtë, Apostulli Pjetër veprroi si zëdhënës i apostujve dhe mbajti një predikim që bindi 3000 njerëz të pagëzoheshin. Ai e bëri këtë në bazë të autoritetit që Jezusi i kishte dhënë.

Tek Mateu 16,18, 19 lexojmë: “Dhe unë po të them gjithashtu: Ti je Pjetri dhe mbi këtë shkëmb unë do të ndërtoj kishën time dhe dyert e ferrit nuk do ta mundin. Unë do t’ju jap çelësat e mbretërisë së qiejve: çfarëdo që të lidhni në tokë, do të jetë e lidhur në qiell dhe çfarëdo që të zgjidhni në tokë, do të jetë i zgjidhur edhe në qiell”.

Kisha e pathyeshme

Jezu Krishti zbulon këtu se Kisha e Tij nuk mund të shkatërrohet: ajo do të mbetet e patundur pavarësisht nga të gjitha sulmet nga forcat e së keqes! Ne nuk duhet të shqetësohemi për mbijetesën e Kishës së Krishtit. I Plotfuqishmi kujdeset mbi të, Krishti do ta çojë punën e tij në përsosmëri.

Megjithatë, le të themi se ajo për të cilën po flasim këtu është Kisha e Krishtit dhe vetëm ajo. Jezusi nuk flet për kishën në kuptimin e një institucioni me strukturë dhe asete, as për të gjitha aktivitetet që ne njohim në bashkësitë tona. Premtimi i Krishtit i referohet vetëm asaj që përbën thelbin e Kishës së tij: Predikimin e Ungjillit, administrimin e sakramenteve dhe bashkësinë e besimtarëve.

Tani Jezusi u dha apostujve të tij detyrën për të predikuar Ungjillin dhe për të administruar sakramentet. Premtimi në lidhje me ekzistencën e Kishës, pra, shkon paralelisht me premtimin ndaj apostujve: “Dhe ja, unë jam me ju gjithmonë, deri në fund të botës” (Mateu 28,20b).

Jepini përparësi asaj që është e përhershme

Krishti gjithashtu u dha apostujve të tij autoritetin për të lidhur dhe zgjidhur (Mateu 18,18). Sipas Katekizmit të Kishës Apostolike së Re (KNK); Pika 7.6.2, ky formulim do të thotë, “që apostujt, së bashku me apostullin kryesor,

përfaqësojnë udhëheqjen shpirtërore të kishës dhe nxjerrin rregullore për jetën e bashkësisë”.

Misioni i udhëheqjes së Kishës që iu besua Apostujve nga Jezusi duhet të kryhet nën dritën e premtimeve të bëra nga Jezu Krishti në lidhje me Kishën dhe postin e apostujve (Mateu 16,18; 28,20b). Më shumë se kurrë, përparësi duhet t’i jepet asaj që do të zgjasë deri në kthimin e Zotit: shpalljes së Ungjillit, administrimit të sakramenteve dhe bashkimit me njëri-tjetrin. Këto prioritete duhet të pasqyrohen në vendimet për përdorimin e burimeve njerëzore dhe financiare.

Shkëmbi si model

Jezusi e quajti Pjetrin Shkëmbi në një moment shumë të caktuar kohor, domethënë pasi Pjetri rrëfeu: “Ti je Krishti, Biri i Perëndisë së gjallë” (Mateu 16,16). Jezusi më vonë ia besoi Pjetrit detyrën për të forcuar vëllezërit e tij (Luka 22,32). Pas ringjalljes së tij, Jezu Krishti e pyeti Pjetrin: “A më do mua?”

Duke e përshkruar Pjetrin si shkëmb, i aftë për t’u bërë ballë forcave të së keqes, Jezusi na e jep Pjetrin si shembull. Asgjë nuk mund të na ndajë nga Krishti nëse ashtu si Pjetri

- do të kemi një besim të fortë të Jezu Krishti, Biri i Perëndisë së gjallë.
- do të jemi të përlulur dhe të vetëdijshëm se ia detyrojmë shpëtimin tonë Jezusit.
- do të jemi vërtet të mbushur me dashuri për Krishtin.

Shërbimi i Pjetrit

Mateu 16,18 mund t’i referohet gjithashtu shërbimit të Pjetrit, d.m.th., shërbimit si shkëmbi: “Kështu Biri i Perëndisë krijoi një lidhje të pazgjidhshme midis shërbimit

të shkëmbit dhe kishës së tij. Shërbimi i shkëmbit dhe Kisha e Krishtit janë dhënë për shpëtimin e njerëzve në Jezu Krishtin” (KNK 7.6.6). Jezu Krishti ka premtuar se do të kujdeset për kishën dhe apostujt e tij. Krijimi i shërbimit të Pjetrit është pjesë e masave që Jezusi merr për të mbrojtur kishën e tij nga forcat e së keqes.

“Shërbimi dhe detyrat që Zoti i besoi apostullit Pjetër kryhen sot nga apostulli kryesor. Në këtë mënyrë ai punon për njëshmërinë, unitetin midis apostujve të dëshiruar nga Zoti (Gjoni 17,20-23) duke forcuar vëllezërit e tij apostujt (Luka 22,32). Ai kullot 'qengjat dhe delet' e kopesë së Krishtit (Gjoni 21,15-17). Shërbimi i apostullit kryesor shprehet në pastrimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të mësimdhënies, zhvillimin e njohurive të reja dhe përhapjen uniforme të dëshmisë së besimit. Apostulli kryesor gjithashtu përcakton rregullat e kishës. Këto detyra përbëjnë “fuqinë kyçe” të postit të apostullit kryesor” (KNK 7.6.6).

Në mbledhjen e Apostujve në Jerusalem, Pjetri ruajti unitetin e Kishës duke i nxitur ata që e udhëhoqën Kishën

të përqendroheshin në atë që ishte e rëndësishme (Veprat e Apostujve 15,6–11). Në botën e sotme, apostulli kryesor duhet të sigurojë që apostujt dhe kishat e distriktit që ata drejtojnë të mbeten të bashkuara pavarësisht nga kulturat dhe traditat e tyre të ndryshme. Ai e bën këtë duke vënë theksin në atë që është vërtet e nevojshme për shpëtim.

Apostulli kryesor duhet gjithashtu të kullojë kopsën e Krishtit duke vepruar si një bari i mirë. Në veçanti, ai duhet të sigurojë që të gjitha delet e Krishtit të kenë atë që është e nevojshme për shpëtimin e tyre. Për ta arritur këtë, ai promovon solidaritetin midis zonave të ndryshme të kishës.

Pjetri, siç e dimë, ishte larg të qenit i përsosur, por dobësia e Pjetrit nuk e pengoi Krishtin të bekonte Kishën e tij nëpërmjet tij. Mund të jemi të sigurt: Jezu Krishti do ta përsosë veprën e tij pavarësisht papërsosmërisë së shërbëtorëve të tij!

(Nga një letër, shkrim i apostullit kryesor)



Illustration: VectorMine/stock.adobe

Masthead

Publikuesi: Jean-Luc Schneider, Überlandstrasse 243, 8051 Zürich/Switzerland

Shtëpia Botuese Friedrich Bischoff GmbH, Frankfurter Str. 233, 63263 Neu-Isenburg/Germany

Editori: Simon Heiniger



Pasqyra

- 13.10.2024 San Francisco (USA)
- 20.10.2024 Glasgow (Britania e Madhe)
- 03.11.2024 Phnom Penh (Kamboxha)
- 05.11.2024 Slem Reap (Kamboxha)
- 17.11.2024 Conakry (Gana)
- 22.11.2024 Accra (Gana)
- 08.12.2024 Kapstadt (Afrika e Jugut)
- 15.12.2024 Omsk (Rusi)
- 22.12.2024 Bad Cannstatt (Deutschland)
- 25.12.2024 do të vendoset më vonë (Francë)
- 29.12.2024 Aachen (Gjermani)

New Apostolic Church
International

